



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI PERSONELIT

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN DREJTOR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PARASHKOLLORE
(KOPSHTI ME USHQIM NË SHKOLLËN 9- VJEÇARE “ISUF FERRA”)**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në shkresën nr.10799 datë 16.12.2015 “Mbi plotësimin dhe transferimin e dokumentacionit pranë NJQV”, në Urdhrin nr.416 prot.6943 datë 01.08.2022 “Për ngritjen, përbërjen, detyrat e komisionit të vlerësimit për zhvillimin e procedurës së emërimit të drejtorit të institucionit publik të Arsimit Parashkollor”, si dhe në Urdhrin nr.210 prot.9219 datë 25.07.2025 ” Për shpalljen konkurimi pozicioni drejtor në kopshtin me ushqim pranë Shkollës 9- vjeçare “Isuf Ferra”,

Drejtoria e Burimeve Njerëzore Shpall konkurimin për pozicionin Drejtor në Kopshtin me ushqim pranë Shkollës 9- vjeçare “Isuf Ferra”, Bashkia Durrës.

I.Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pozicionin Drejtor i institucionit publik të arsimit parashkollor janë:

- Të ketë diplomë të ciklit të parë Bachelor, të formimit për mësues i arsimit parashkollor (Master).
- Të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune si mësues i arsimit parashkollor.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II.Çdo kandidatë duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm, jo me vonë se 15 ditë pas shpalljes së këtij njoftimi.

1. CV-në dhe kërkesën për t’u pranuar në institucionin arsimor parashkollor.
2. Të gjitha diplomat që disponon kandidati së bashku me listat e notave.
3. Çertifikatën e trajnimit për drejtues të institucionit arsimor parauniversitar ose vërtetimin se është në proces trajnimi, nëse ka.
4. Dëshminë e penalitetit të lëshuar jo më herët se 3 muaj para datës së aplikimit.
5. Dy rekomandime nga mësues, drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të institucioneve që kanë punuar me kandidatin gjatë viteve të fundit.
6. Vetëdeklarimin në lidhje me vërtetësinë e dokumentave dhe informacionit të dhënë në procesin e aplikimit.

Disa nga detyrat që do të kryejë Drejtori i Kopshtit janë:

1. Është përgjegjës për respektimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, rregullores së brendshme të institucionit, disiplinës formale në punë, kodit të etikës dhe sjelljes në institucion.
2. Garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve, monitoron punën e përditshme bazuar në parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, në përputhje me parashikimet e konventës për të Drejtat e fëmijëve.
3. Monitoron respektimin e kurikulës së miratuar, realizon dhe ndjek procedurën e regjistrimit të fëmijëve, si edhe administron dosjet personale të stafit.
4. Ngre komisionin e disiplinës, komisionin e etikës dhe sjelljes në institucion, komisionin e fëmijëve më nevoja të veçanta, komisionin e blerjeve, si edhe çdo komision tjetër që ka lidhje me funksionimin dhe menaxhimin e punës në institucion.
5. Organizon dhe dokumenton rregullisht mbledhjet me prindër, si edhe ngre këshillin e prindërve dhe bordin e prindërve.
6. Monitoron kushtet higjienike në institucion dhe zbatimin e menisë së miratuar.
7. Monitoron zbatimin e detyrave funksionale të stafit mësimor dhe jomësimor.
8. Dokumenton të dhëna në regjistrin e ditëngrënies, si edhe realizon filtrin e përditshëm.
9. Administron dokumentacionin e familjeve në nevojë, të cilat përfitojnë shërbim parashkollor pa pagesë.
10. Ndjek likuidimin e faturave mujore të ditëngrënies brenda afateve të përcaktuara dhe është përgjegjëse për debinë e akumuluar.
11. Mban qëndrim jodiskriminues ndaj gjinisë, racës, kulturës, besimit, prejardhjes familjare dhe modelon qëndrim pozitiv tek stafi, fëmijët dhe komuniteti.....etj.

Afati për dorëzimin e dokumentave është deri më datë 12.08.2025 .

Aplikimi bëhet duke dorëzuar dokumentat pranë Zyrës së Marrëdhënies me Publikun, origjinale ose të njësuar me orgjinalin.

Kandidatët e kualifikuar sipas dokumentacionit të dorëzuar do të njoftohen në faqen zyrtare të Bashkisë dhe me postë elektronike më datë 14.08.2025

Intervista me gojë do të zhvillohet më datë 18.08.2025 ora 11⁰⁰, në ambjentet e Bashkisë Durrës.

Klasifikimi përfundimtar referuar komisionit të vleresimit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës më datë 20.08.2025